



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2024:104360

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06715698

PPP.nr.10/24

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, si gjykatë përmbarimore e shkallës së parë, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi, dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, **në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.M. “Ekoregjioni” sh.a. me seli në Prizren, Rruga “ T. S.” nr..., Njësia Operative në Dragash, Rr.” D.” p.n. kundër debitorit Xh. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit, lidhur me përmbarimin e e borxhit në shumën prej 921.48 €**, jashtë seance me datën 15.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike përmbarimore **NDËRPRITET** për shkak të vdekjes se debitorit Xh. Q. ish nga fshati..., Komuna e Dragashit.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e debitorit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e pales kreditore dhe atë në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Prizren Dega në Dragash është inicuar procedura përmbarimore e kreditorit KRM “Ekoregjioni” sh.a me seli në Prizren, Rruga “ T. S.” nr..., Njësia Operative në Dragash, Rr.” D.” p.n., kundër debitorit Xh. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit, lidhur me përmbarimin e borxhit në shumën prej 921,48 €.

Gjykata ka pruar propozimin për përmbarim me urdhër që mban shenjë P.nr.405/24 të dt. 06.03.2024 të Përmbaruesit Privat E. H. nga Prizreni me të cilin është lejuar përmbarimi i propozuar këtu i borxhit sipas dokumentit autentik – faturës në shumën prej 921,48 euro si dhe shpenzimeve të përmbarimit e gjithashtu edhe komplet lënden.

Në ndërkohë gjykata është njoftuar se debitori ka ndërruar jetë, fakt ky që bazohet edhe nga parashpresa e djalit të debitorit S. Q. si dhe Certifikata e vdekjes e bashkangjitur prapësismit Nr.5/2015RV/5... me numer rendor 50 dhe numer serik V 1066... e dt. 13.03.2024.

Prandaj gjykata konform dispozitave ligjore të Ligjit të procedurës Përmbarimore neni 35 par. 4, citojmë: “ Në rast të vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjkata brenda afatit prej 15 ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëgimtareve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga radha e personave që kanë në posedim pasurinë që është objekt përmbarimi dhe vazhdon procedurën. Gjkata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e parashtrimt të kërkesës... ”.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform nenit 35 par. 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2024:104360, 15.01.2025**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.